



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 11, datë 28.01.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJE NDËRTIMI INFRASTRUKTURE PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I LINJËS 110 kV GJIRI I LALËZIT- FUSH KUQE DHE SHTESA E
NËNSTACIONIT 110 kV FUSH KUQE”, ME VENDNDODHJE NË BASHKITË KURBIN,
DURRËS DHE KRUIJË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Operatorit të Sistemit të Trasmetimit sh.a (OST), Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Leje Ndërtimi Infrastruktura për objektin: “Ndërtimi i Linjës 110 kV Gjiri i Lalëzit - Fush Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110 kV Fush Kuqe”, me vendndodhje në Bashkitë Kurbin, Durrës dhe Krujë, me zhvillues Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kurbin, Durrës dhe Krujë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga kryetari, ministri i linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 21/05 / 2025